



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 111/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.03.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-45458-12-03-2019, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë*”, me fond limit 166.856.450,4 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k.
Lagja “Vasil Shanto”, Bulevardi “Skënderbeu”, pas Kinema Millenium, Shkodër

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.12.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-45458-12-03-2019, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”, me fond limit 166.856.450,4 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 06.01.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--|--------------------------------|
| 1. BOE “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k. | 130.086.292 lekë, skualifikuar |
| 2. “Sori -AL” sh.p.k. | 166.021.272 lekë, kualifikuar |
| 3. “Dion-AL” sh.p.k. | 166.197.690 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 15.01.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

[...]

Anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “NIKA” shpk nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit teknik pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk plotësohet vlera minimale prej 40 % për furnizimet e ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

II.4. Në datën 22.01.2020, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes pretendon se:

[...] *Operatori ynë “Nika” sh.p.k. në bashkëpunim me operatorin ekonomik “Shabani” sh.p.k. kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit të zhvilluar më datën 06.01.2020 me objekt Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë me fond limit 166.856.450,4 lekë (pa TVSH), duke plotësuar ligjërisht të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe duke paraqitur ofertën ekonomike 130.086.292 lekë me TVSH. Më datën 15.01.2020 njoftohemi nëpërmjet mesazhit elektronik në llogarinë tonë në faqen zyrtare të APP-së me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave të Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara.*

Ky vendim bën vlerësimin e procedurës kuotimin e oe-ve pjesmarrës dhe na skualifikon ne si BOE nga procedura e mëtejshme me pretendimin se:

Anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “NIKA” shpk nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit teknik pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk plotësohet vlera minimale prej 40 % për furnizimet e ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

Vendimi është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo në fakt që ekzistojnë. Nga ana jonë janë plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko ligjor. Së pari në lidhje me pretendimin se nuk përmbushet pika 1 për kapacitetin teknik duke mosplotësuar vlerën prej 40% furnizimet e ngjashme të tre viteve të fundit nuk qëndron. Pasi në SPE operatorët ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k. kanë paraqitur furnizime të ngjashme të realizuara tre vitet e fundit në vlerën 40% të vlerës së fondit limit. Kjo është lehtësisht e verifikueshme nga kontratat dhe faturat e realizuara me institucione shtetërore dhe subjekte private si më poshtë:

Furnizimi Komanda Dhjetor Nika sh.p.k. (nr. Faturës 188)

Furnizime të ngjashme Nika sh.p.k. me Shpresa sh.p.k. (nr. E faturave 12; 13; 25; 75; 113; 143; 155; 182;212;282;319;16;14;256;)

Kontrata dhe Fatura 2017 Komonda Mbështetëse Nika sh.p.k.(Nr. Faturave 1; 7; 23; 47; 81; 120; 144;172;186;233;268;298)

Komanda Mbështetëse Reparti 4001 Tiranë Fatura 2019 (Nr Faturave 12; 37; 55; 77; 94; 124; 145; 466; 476)

Komanda Shtator Nëntor 2019 (Nr. Faturave 476;168;184)

Fatura Katering me klient Mariol Hoxha dhe Shabani sh.p.k. (Nr. I faturave 4; 6; 7; 8; 9; 10; 11; 12; 13;14).

Fatura Katering me klient Xhuljan Goxhaj dhe Shabani shp.k. (Nr i faturave 19; 20; 21; 22; 23; 29; 30;31;32;33)

Kontratë Furnizimi “Colombo” sh.p.k. dhe “Shabani” sh.p.k. (Nr i Faturës 36).

Furnizime të ngjashme Junik sh.p.k. dhe Nika sh.p.k.

Së dyti pas verifikimit ekonomik të faturave për furnizime të ngjashme rezultojnë se llogaritjet janë realisht sipas vlerës së kërkuar në dst pika 3.3. kapaciteti teknik 1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit.

Furnizimet/Punët e ngjashme e paraqitura në vlerën ekonomike hedhin poshtë arsyen e skualifikimit duke konsideruar formulën e llogaritjes së ofertës.

Furnizime total Nika + Shabani 67480288.47

Fond limit 166856450

Kontrata e kërkuar 40% 66742580

Furnizime Nika+Shabani 67480288

Diferenca mbi limitin e kërkuar 737708

Nisur nga një interpretim lateral i kërimit të bërë nga ana juaj sqarojmë se kërkesa paraprake e bërë në DST ka të bëjë më shumë totale furnizimesh të ngjashme të kryera nga operatori ekonomik. Qëllimi i JV ka të bëjë me faktin se i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor duhet të vlerësohet si i paraqitur nga një operator ekonomik, pavarësisht faktit se oferta e paraqitur nga një bashkim operatorësh ekonomikë. Në vetvete ky bashkim operatorësh pasi ka rënë dakord për të paraqitur një ofertë të vetme në këtë procedurë prokurimi kanë marrë përsipër plotësimin e kriterëve në bazë të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim (i përcaktuar në aktmarrëveshjen përkatëse)dhe kanë përcaktuar një përfaqësues të tyre (i përcaktuar në prokurën e posacme).

Së treti në fazën e vlerësimit nga KVO shoqëria Nika sh.p.k. fakton e para me vlerë ekonomike në raport me operatorët e tjerë ekonomikë “Sori Al” sh.p.k. dhe Dori al” sh.p.k. Oferta jonë plotëson ekonomikisht dhe teknikisht kërkesat e autoritetit kontraktor për objektin e tenderuar. Gjithashtu përmbushim standartet ligjore profesionale dhe operuese duke dëshmuar në përfundim me sukses të furnizimeve dhe kontratave me institucione shtetërore dhe subjekte private. Cdo konstatim vërtetohet lehtësisht nga ana juaj përmes të dhënave në dokumenta.

Cilësia e shërbimeve të ofruara në fushën e ushqimeve apo shërbimeve katering rrit besueshmërinë kundrejt autoritetit tuaj, serioziitetin dhe eficientësinë e shoqërisë tonë.

Sqarojmë se me këtë vendimarrje të kundraligjshme dhe të padrejtë i shkaktohet një dëm relativisht i madh buxhetit të institucionit tuaj dhe taksave të shtetit shqiptar. Të nodhur në këto kushte ne sqarojmë se me këtë kuotim po bëhet një padrejtësi e hapur ndaj subjektit tonë.

Sa më sipër kërkojmë nga ana juaj të rishikohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave, të kualifikohet dhe të shpallet fituese shoqëria “Nika” sh.p.k. në rast të kundërt jemi të detyruar tu drejtohem organeve më të larta administrative dhe gjyqësore për të vënë në vend të drejtat e shkelura në lidhje me barazinë në tendera. Gjithashtu dhe organeve të prokurorisë për të marrë masa ndëshkuese ndaj shkelësve të këtyre të drejtave. [...]

II.5. Me shkresën nr. 109/3 prot., datë 29.01.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues duke mos e pranuar ankesën. Konkretisht, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

[...]Prane Agjencise se Blerjeve te Perqendruara eshte depozituar ankesa protokolluar me tonen me nr. 109 prot. date 22.01.2020 nga ofertuesi "Nika" Shpk, per vleresimin e ofertes se paraqitur ne procedure e prokurimit, "Procedure Hapur-Sherbime" - Marreveshje Kuader me afat 4(kater) vite, me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me objekt: "Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Spitalin Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlore", me fond te marreveshjes kuader 166,856,450.4 leke (pa TVSH), me nr. REF-45458-12-03-2019, me date te mbylljes se vleresimit 15.01.2019. Ankesa eshte paraqitur brenda 7 diteve nga dita kur ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni mbi vleresimin e ofertes. Me marrjen e ankeses me shkrim, Organi Qendror Bleres pezulloi vazhdimin e procedures se prokurimit deri ne marrjen e vendimit perfundimtar sipas parashikimeve ne nenin 63 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik". Ne mbeshetje te nenit 63 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, pika 2, 3, 5: "Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, se pari, me shkrim autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 diteve nga dita kur ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet të ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji. Me marrjen e ankeses me shkrim. autoritet i kontraktor pezullon vazhdimin e procedures së prokurimit, derisa ankesa të jete shqyrtuar plotesisht perfshire dhe nxjerrjen e nje vendimi perpara skadimit të afatit kohor. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesen dhe tner nje vendim le arsyetuar brenda 7 diteve pas marrjes se ankeses, të cilin duhet t'ia njoftoje ankuesit jo me vonë se ditën vijuese të punes. Ndaj vendimit perfundimtar të autoritetit kontraktor mund të behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me piken 6 e ne vijim të ketij neni" si dhe te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik " e ndryshuar, neni 78, pika 5: "Gjate procedures së prokurimit, ankesat kunder vendimeve te autoritetit kontraktor duhet ti dorezohen fillimisht prane autoritetit kontraktor brenda 7 diteve nga dita e neserme punes, nga data kur ankimuesi eshte vene: ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per këto shkelje të ligjit ..., pasi u shqyrtuan te gjitha dokumentat e vena ne dispozicion per kete procedure prokurimi, ju komunikojmë vendimin si me poshte: Ofertuesi “Nika” sh.p.k. ka ankimuar skualifikimin për mospërmbushje të pikës 1 të seksionit 3.3. Kapaciteti Teknik në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit Shtojca 8 në dokumentat e tenderit ku përcaktohet: 1.Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit.Me pretendimin si vijon: [...] Operatori ynë “Nika” sh.p.k. në

bashkëpunim me operatorin ekonomik “Shabani” sh.p.k. kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit të zhvilluar më datën 06.01.2020 me objekt Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” me fond limit 166.856.450,4 lekë (pa TVSH), duke plotësuar ligjërisht të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe duke paraqitur ofertën ekonomike 130.086.292 lekë me TVSH. Më datën 15.01.2020 njoftohemi nëpërmjet mesazhit elektronik në llogarinë tonë në faqen zyrtare të APP-së me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave të Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara. Ky vendim bën vlerësimin e procedurës kuotimin e oe-ve pjesmarrës dhe na skualifikon ne si BOE nga procedura e mëtejshme me pretendimin se:

Anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik “NIKA” shpk nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit teknik pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk plotësohet vlera minimale prej 40 % për furnizimet e ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

Vendimi është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo në fakt që ekzistojnë. Nga ana jonë janë plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko ligjor. Së pari në lidhje me pretendimin se nuk përmbushet pika 1 për kapacitetin teknik duke mosplotësuar vlerën prej 40% furnizimet e ngjashme të tre viteve të fundit nuk qëndron. Pasi në SPE operatorët ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k. kanë paraqitur furnizime të ngjashme të realizuara tre vitet e fundit në vlerën 40% të vlerës së fondit limit. Kjo është lehtësisht e verifikueshme nga kontratat dhe faturat e realizuara me institucione shtetërore dhe subjekte private si më poshtë:

Furnizimi Komanda Dhjetor Nika sh.p.k. (nr. Faturës 188)

Furnizime të ngjashme Nika sh.p.k. me Shpresa sh.p.k. (nr. E faturave 12; 13; 25; 75; 113; 143; 155; 182;212;282;319;16;14;256;)

Kontrata dhe Fatura 2017 Komonda Mbështetëse Nika sh.p.k. (Nr. Faturave 1; 7; 23; 47; 81; 120; 144; 172; 186;233;268;298)

Komanda Mbështetëse Reparti 4001 Tiranë Fatura 2019 (Nr Faturave 12; 37; 55; 77; 94; 124; 145; 466; 476)

Komanda Shtator Nëntor 2019 (Nr. Faturave 476;168;184)

Fatura Katering me klient Mariol Hoxha dhe Shabani sh.p.k. (Nr. I faturave 4; 6; 7; 8; 9; 10; 11; 12;13;14).

Fatura Katering me klient Xhuljan Goxhaj dhe Shabani shp.k. (Nr i faturave 19; 20; 21; 22; 23; 29; 30; 31;32;33)

Kontratë Furnizimi “Colombo” sh.p.k. dhe “Shabani” sh.p.k. (Nr i Faturës 36).

Furnizime të ngjashme Junik sh.p.k. dhe Nika sh.p.k.

Së dyti pas verifikimit ekonomik të faturave për furnizime të ngjashme rezultojnë se llogaritjet janë realisht sipas vlerës së kërkuar në dst pika 3.3. kapaciteti teknik 1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit.

Furnizimet/Punët e ngjashme e paraqitura në vlerën ekonomike hedhin poshtë arsyen e skualifikimit duke konsideruar formulën e llogaritjes së ofertës.

Furnizime total Nika + Shabani 67480288.47

Fond limit 166856450

Kontrata e kërkuar 40% 66742580

Furnizime Nika+Shabani 67480288

Diferenca mbi limitin e kërkuar 737708

Nisur nga një interpretim lateral i kërimit të bërë nga ana juaj qarojmë se kërkesa paraprake e bërë në DST ka të bëjë më shumë totale furnizimesh të ngjashme të kryera nga operatori ekonomik. Qëllimi i JV ka të bëjë me faktin se i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor duhet të vlerësohet si i paraqitur nga një operator ekonomik, pavarësisht faktit se oferta e paraqitur nga një bashkim operatorësh ekonomikë. Në vetvete ky bashkim operatorësh pasi ka rënë dakord për të paraqitur një ofertë të vetme në këtë procedurë prokurimi kanë marrë përsipër plotësimin e kriterëve në bazë të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim (i përcaktuar në aktmarrëveshjen përkatëse) dhe kanë përcaktuar një përfaqësues të tyre (i përcaktuar në prokurën e posaçme).

Së treti në fazën e vlerësimit nga KVO shoqëria Nika sh.p.k. fakton e para me vlerë ekonomike në raport me operatorët e tjerë ekonomikë "Sori Al" sh.p.k. dhe Dori al" sh.p.k. Oferta jonë plotëson ekonomikisht dhe teknikisht kërkesat e autoritetit kontraktor për objektin e tenderuar. Gjithashtu përmbushim standartet ligjore profesionale dhe operuese duke dëshmuar në përfundim me sukses të furnizimeve dhe kontratave me institucione shtetërore dhe subjekte private. Cdo konstatim vërtetohet lehtësisht nga ana juaj përmes të dhënave në dokumenta.

Cilësia e shërbimeve të ofruara në fushën e ushqimeve apo shërbimeve katering rrit besueshmërinë kundrejt autoritetit tuaj, seriozitetin dhe efikasitetin e shoqërisë tonë.

Sqarojmë se me këtë vendimarrje të kundraligjshme dhe të padrejtë i shkaktohet një dëm relativisht i madh buxhetit të institucionit tuaj dhe taksave të shtetit shqiptar. Të nodhur në këto kushte ne sqarojmë se me këtë kuotim po bëhet një padrejtësi e hapur ndaj subjektit tonë.

Sa më sipër kërkojmë nga ana juaj të rishikohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave, të kualifikohet dhe të shpallet fituese shoqëria "Nika" sh.p.k. në rast të kundërt jemi të detyruar të drejtohem me organet më të larta administrative dhe gjyqësore për të vënë në vend të drejtat e shkelura në lidhje me barazinë në tendera. Gjithashtu dhe organet të prokurorisë për të marrë masa ndëshkuese ndaj shkelësve të këtyre të drejtave. [...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dokumentet e dorëzuara nga BOE "Shabani 2002" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k. pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertës së tij, konstaton si me poshtë:

Per BOE "Shabani 2002" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k. , Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 15.01.2020, kualifikimin e tij ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 15.01.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Nika" sh.p.k. dhe konstatoi:

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 1 në seksionin 3.3. Kapaciteti teknik" në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit shtojca 8. BOE "Shabani 2002" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k. ka dorëzuar dokumentacionin me emërtim: Kontratë Furnizimi me Colombo ok; Faturat Catering me Klient; Furnizime të Ngjashme Nika me Shpresën; Komanda Shtator Nentor 2019: Fatura Furnizimi Komanda Dhjetor 2019: Fatura Korrik 2019 Komanda; Furnizime të Ngjashme me Junik; Komanda Mbeshtetëse Fatura 2018; Komanda Fatura 2017; Komanda Mbeshtetëse Fatura 2019: Komanda F Mbeshtetëse;.

Në kriterin e përcaktuar në pikën 1 në seksionin 3.3. kapaciteti teknik në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit shtojca 8 parashikohet: 1.Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit, pra nje vlerë jo më e vogël se 66.742.580 lekë pa TVSH.

Në Akt Marrëveshjen për bashkimin e përkohshëm të shoqërive të dorëzuar në spe me nr. 15144 REP/7474 Kol, ndërmjet “Shababi 2002” sh.p.k. dhe “Nika” sh.p.k. rezulton se masat në të cilët shoqëritë do të kryejnë punime janë 93.9% Shoqëria “Nika” sh.p.k. dhe 6.1% “Shabani 2002” sh.p.k.

Nga verifikimi i faturave nga BOE rezulton se kjo shifer nuk eshte realizuar ne lidhje me perqindjen e percaktuar ne aktmarreshjen e dorezuar. Ofertuesi "Shabani 2002" sh.p.k. ka permbushur kriterin ndersa per ofertuesin "Nika" sh.p.k. rezulton se disa nga faturat e dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik jane fatura te perseritura dy here por te dorezuara ne foldera te ndryshem, Gjithashtu nga verifikimi rezulton se disa fatura nuk e permbushin kriterin e percaktuar "te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures ", date e zhvillimit te seciles ka qene data 06.01.2020. Pra ofertuesi pjese e BOE "Nika" SHPK nuk ka perrnbushur kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Sqarojme se ne baze te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik " e ndryshuar. neni 74 pika 3 percaktohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Bazuar ne ligjin nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar neni 53 pikeë 3 “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”. Organi Qëndror Blerës ka bërë skualifikimin e BOE Shababi 2002” sh.p.k. dhe “Nika” sh.p.k..

Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit “Nika” sh.p.k. nuk qëndron.

Sa më sipër, ju bëjmë me dije se kundër vendimit të organit qëndror blerës mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 63, pika 6 të LPP-së[....]

II.6. Në datën 06.02.2020, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon se:

[...]Operatori yne ekonomik “Nika” sh.p.k ne bashkepunim me operatorin ekonomik "Shabani 2002" sh.p.k. ka marre pjese ne proceduren e prokurimit te zhvilluar me date 06.01.2020 me objekt "Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlore" me fond limit 166 856 450. leke pa TVSH, duke plotesuar ligjerisht te gjitha kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe duke paraqitur oferten ekonomike 130,086,292Lek me T.V.SH.

Me datën 15.01.2020 njoftohemi nepermjet mesazhit elektronik ne llogarinetone ne faqen zyrtare te Agjencise se Prokurimeve Publike me Vendimin e Kornisionit te Ofertave te Agjencia e Blerjeve te Perqendruara. Ky vendim ben vleresimin e procedures kuotimin e operatoreve ekonomike pjesemarres dhe na skualifikon ne si BOE (Bashkim i Operatoreve Ekonomik) nga procedura e metejshme me pretendimin se: Anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik "Nika" shpk nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit teknik pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk plotësohet vlera minimale prej 40 % për furnizimet e ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

Ne mbështetje të nenit 63 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik ", i ndryshuar, pika 2,3,5 kemi paraqitur ankese prane Autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, me date 21.01.2020, lidhur me arsyen e skualifikimit ne proceduren e sipermendur. Shoqeria "Nika" sh.p.k ka ankimuar arsyen per mospermbushje te pikes 1 te seksionit 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" Shtojca Nr.8 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet : 1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi mori ne shqyrtim ankesen e paraqitur nga Shoqeria "NIK.A" sh.p.k argumenton: Në Akt Marrëveshjen për bashkimin e përkohshëm të shoqërive të dorëzuar në spe me nr. 15144 REP/ 7474 Kol, ndërmjet "Shabani 2002" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k. rezulton se masat në të cilët shoqëritë do të kryejnë punime janë 93.9% Shoqëria "Nika" sh.p.k. dhe 6.1% "Shabani 2002" sh.p.k.

Nga verifikimi i faturave ne sistem elektronik, kjo shifer nuk eshte realizuar ne lidhje me perqindjen e percaktuar ne akt marreveshjen e dorezuar. Ofertuesi "Shabani 2002" sh.p.k. ka permbushur kriterin, ndersa ofertuesi "Nika" sh.p.k. disa nga faturat e dorëzuara në sistemin e prokurimit elektronik janë fatura të përsëritura dy here, por të dorëzuara në foldera të ndryshëm. -Disa fatura nuk e përmbushin kriterin e percaktuar "te realizuara gjate 3 viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures", date e zhvillimit te seciles ka qene data 06. 01.2020. Pra, BOE "Nika" sh.p.k nuk ka permbushur kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Shoqeria "Nika" sh.p.k. mori njoftim per vendimin me date 29.01.2020, ne adresen elektronike te saj dhe dorezimit permes pastes me date 30.01.2020.

Ne ushtrim te se drejtes se ankimit, qe parashikon neni 63, pika 6 te LP P, duke respektuar afatin 10 ditor, qe nga dita e marrjes se njoftimit te vendimit dhe legjitimitimin substancial mbështetur ne prova dhe fakte, kunder vendimit te Agjencise së Blerjeve të Perqendruara argumentojme si me poshte vijon:

Se pari, nga verifikimet e bera nga stafi profesional i shoqerise "NIK.A" sh.p.k rezulton se ne sistem elektronik nuk kemi fatura te perseritura dy here dhe ne foldera te ndryshme, sic citohet ne vendim.

-Duke aluduar ne te kunderten edhe sikur te ngarkohet dy here nje dokument ne sistemin elektronik te prokurimit nuk perben arsye skuafikimi, perderisa vlerat e fatures/ve nuk ndikojne ne llogaritjen dhe arritjen e vleres se 40% te fondit limit te objektit, per pune te ngjashrne.

-Ne vendim nuk emertohen faturat qe Autoriteti Kontraktor prentendon te jene perseritur 2(dy) here dhe me emertime ne foldera te ndryshem, pasi ne ankimin qe kemi bere jane renditur te gjitha faturat me numer, date dhe vlerat perkatese (BOE ""Nika" dhe "Shabani 2002").

-Llogaritja ekonomike eshte realizuar ne vleren perkatese te cdo fature duke mos perseritur fatura te njejta. Ekonomikisht rezulton se llogaritja e vleres 40% pune te ngjashme eshte matematikisht ne proporcion me fondin limit, minimumin e kerkuar ne kriterin per kapacitetin teknik dhe ndarjen e punimeve ne masen e caktuar ne formen ligjore te bashkimit te operatoreve (Akt marreveshja dhe Prokura e Posacme), ne disponueshmerine mete madhe te perfaqesimit per objektin e prokuruar. Ligji per Prokurimin Publik ne nenin 45 te tij (Kriteret e skualifikimit te operatoreve

ekonomike), nuk percakton kriter skualifikues apo pretendim ligjor ngarkimin e dokumentave sipas DST-se, te ngarkuara dy ose me shume here ne sistem, si dhe emertimin ndryshe ne qelizat informatike (folderave), meqe nuk ndryshon kriterin dhe kushtin qe duhet permbushur nga operatori ekonomik (40% e vleres se fondit limit, pune te ngjashme)

Se dyti, faturat e ngarkuara ne sistem plotesojne kriterin te percaktuar ne DST. Operatori ekonomik/bashkimi i operatoreve duhet te plotesoje kriterin "punë të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedures". Perseri, AK nuk percakton cila nga faturat nuk permbush kriterin e siperpermendur.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor referon dy pika: 3 (tre) vitet e fundit dhe data e zhvillimit te procedures. Ne nenin 46, pika l, germa "b" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 (LPP i ndryshuar) parashikohet shprehimisht: "Operatores ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen pasi te kene permbushur të gjitha kriteret qe autortieti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe që ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

Ne interpretim literal te frymes se ligjit ne bashkerendim me parimet e pergjithshme dispozitat hierarkine e akteve dhe VKM-te ne baze dhe zbatim te tij, favorizon konkurrencen e lire, sipermarrjen ne pune, mallra, sherbime publike, te drejtat e operatoreve ekonomike mbi bazat e zhvillimit te procedure ligjore dhe eficence ekonomike.

Shprehimisht, ligji nuk parashikon ne dispozita fillimin dhe mbarimin e periudhes 3 vjecare, e cila lidhet me daten e zhvillimit te procedures se tenderit. Faturat Tatimore jane mjet ekzekutimi faktik i kontratave te realizuara, per furnizime apo mallra. Keto, te fundit te paraqitura nga shoqeria "Nika" sh.p.k. jane tre viteve te fundit kalendarike dhe tatimore.

Nisur nga dokumentacioni i ngarkuar faktohet data e realizimit te punes nga fatura tatimore leshuar nga subjekti, qe ligjerisht dhe ekonomikisht i perket 3 viteve te fundit. Konsiderohet llogaritje e periudhes punime te ngjashme data e realizimit te tyre.

-Procedura per objektin e prokuruar nga Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, qe nga data e hapjes se tenderit ka pesuar ndryshime gjate zhvillimit te saj. Dosja e dokumentave te tenderit eshte krijuar me date 03 Dhjetor 2019, publikuar ne sistem me daten 04.12.2019. Paralelisht eshte hedhur edhe njoftimi i kontrates, krijuar me dat 03.12.2019, me numer njoftimi CN/31054/12032019, modifikuar me dt. 04.12.2019, e cila paraqet afatin kohor per dorezimin e ofertave Data: 27.12.2019 Ora: 11:00. Pas dorezimit, te ofertes ekonomike si bashkim operatoresh dhe mbylljes se afatit kohor ora 11 :00 elektronikisht i afirmuar njoftohemi per shtyrjen e dates se tenderit me Shtojcen Nr.1, date 27.12.2019 "Permodifikimin e dokumenteve te tenderit.. "Ne dokumentet e tenderit, behen ndryshimet si me poshte: Tek Shtojca8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit":

Pika

3.3, Kapaciteti teknik, nenpika 3: Keshtu afati kohor per dorezimin dhe hapjen e ofertave, shtyhet per ne daten 06.01.2020, ora 14:00. Ne argumentim te ligjit te prokurimit publik dhe afateve kohore ne procedure prokurimi, referojme llogaritjen e periudhes apo kohes nga data e hapjes se ofertave, qe marrin gjurruen e njoftimit ne sistem elektronik dhe deri ne mbylljen e tyre. Prokurimi i objekteve eshte nje procedure administrative, qofte ne aktet po ashtu afatet. Periudha vlefshmerise do te shqyrtohet nga viti 2017 deri ne fundin e vitit 2019. Ekzekutimi dhe pervoja e duhur e puneve vertetohet sipas dokumentacionit, vleres ekonomike, kapaciteteve te tjera financiare dhe teknike. Keto pasqyrohen ne xhiro vjetore dhe bilancet e shoqerise .

-Neni 53 pika 3, neni 54, 55 (LPP-se) dhe VKM nr. 914 date 29.12.2014 (Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik), ndryshuar me VKM nr. 80, date 14.2.2018 (i perditesuar), interpretohen parimisht dhe specifikisht duke mos kundërshtuar njera-tjetren. VKM-ja nxirret ne baze dhe funksion te ligjit dhe hierarkise se akteve ligjore apo normative. Ne cdo rast prevalon Ligji Prokurimit Publik.

Dispozita VKM-se neni 74 pika 3 percakton "Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushë kërkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 46 LPP Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale duhet te permbushen nga i gjithe bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes, ne pune, sherbim apo furnizim te percaktuara ne akt marreveshje".

Qellimi i nenit 46 te LPP -eshte favorizues dhe jo diskriminues. Operatorët kualifikohen pasi te kene përrmbushur te gjitha kriteret profesionale, licensat teknike, kualifikimet e stafit, kapacitetet organizative, makinerite, reputacioni, personeli, pervoja e duhur , gjendje ekonomike• financiare te marra se bashku (vleresim kumulativ) duke ndikuar ne besueshmeri.

Kërkesat per kualifikim hartohen qe te stimulojne biznesin e vogel dhe te mesem per pjesemarrje dhe sipas rregullave te procedures se prokurimit. Shoqeria "Nika" sh.p.k. permbush te gjitha kapacitet e rnesiperme dhe ne raport me perqindjen ne fornen ligjore (Akt - Marreveshjes). Realizimi i formes ligjore te bashkimit zbaton dhe njekohesisht arrin zbatimin dhe qellimin e dispozites per nxitje pjesemanje dhe marrjen persiper te punes,

Shqyrtimi i ofertave behet ne perputhje me kërkesat dhe specifikimet duke mos rënë ndesh me nenin 54. Vleresimi i nje oferte ekonomike behet ne teresine e ligjit te prokurimit dhe jo ne arsye te pabazuara, qe nuk konsiderohen te tilla ne nenin 45. Vete neni 45 i LPP nuk parashikon skualifikime per shkaqe te tilla. Theksojme se rastet e skualifikimit te parashikuara ne kete nen jane shteruese dhe nuk mund te zgjerohen as me ndonje akt nenligjor dhe as nga autoritetet kontraktore. Argumentimi i Autoritetit Kontraktore per fatura jashte afatit te 3 vjecar te zhvillimit te procedures eshte sa abuziv dhe i pambeshtetur ne ligj, pasi neni 46 i LPP parashikon afate financiare dhe per me teper qe vete DST parashikon shprehimisht "pune te ngjashme te realizuara giate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures" dhe jo "pune te ngjashme te realizuara giate tre viteve te fundit nga data e mbyllies se ofertave ".

Konfondimi nga ana e autoritetit kontraktor te shprehjes "data e zhvillimit te procedures" ne ate te "data e mbylljes se ofertave" data 06.01.2020 eshte abuziv, diskriminues dhe i pabazuar si ne ligj edhe ne fakte, pasi zhvillimi i procedures se nje tenderi eshte nga momenti i hapjes se ofertave deri ne mbylljen e tyre. Duke qene se nje procedure tenderi eshte edhe procedure administrative, Kodi i Procedurave Administrative (KPA) ne nenin 3 te tij ka perkufizuar ate si nje veprimtari e nje

organi publik, me qellim përgatitjen dhe miratimin e veprimeve konkrete administrative, ekzekutimin e tyre dhe rishikimin e tyre me mjete ligjore administrative. Pra e thene ndryshe edhe ne interpretim te KPA "pune te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te (fundit nga data e zhvillimit te procedures" e parashikuar ne kriterin e pikes 1, seksioni 3.3 kapaciteti teknik tek kriteret e vecanta, shtoja 8 e DST nuk eshte data e mbylljes ofertave, data 06.01.2020, sic pretendon autoriteti kontraktor, por momenti dhe veprimtaria nga hapja e ofertave deri ne mbylljen e tyre. Prandaj nga ana jone cmohet se ky interpretim qe i ben autoriteti kontraktor vete kriterëve te percaktuara ne DST eshte abuziv dhe ne kundërshtim me ligjin.

Te nderuar zonja dhe zoterinjtë KPP! Sic kemi theksuar edhe me siper, vendimi nr. 109/2 prot, dt. 29.01.2020 eshte i paarsyetuar, pasi KSHA prane Agjensise se Blerjeve te Perqendruara shprehet ne menyre te pergjithshme se disa fatura jane perseritur disa here ne foldera te ndryshem, por pa percaktuar se cilat jane keto fatura nominalish dhe se dyti po sipas KSHA rezulton se disa fatura nuk e permbushin kriterin e percaktuar "te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures", perseri pa percaktuar se cilat fatura nominalisht nuk permbushin kete kriter. Theksojme se ne ankimin drejtuar ABP ne kemi percaktuar ne menyre nominative cdo fature me numer date dhe vleren perkatese. Ky fakt perben qe vendimi ne fjale te jete i paarsyetuar, pasi vendimet e Autoritetit Kontraktues, ne rastin konkret KSHA prane ABP duhet te argumentonte me prova konkrete dhe jo ne terma te pergjithshme duke percaktuar nominalisht se cilat fatura nuk permbushin kriteret e mesiperme. Duke qene se kemi te bejme me nje procedure administrative dhe vendimet e KSHA jane akte administrative, atehere duhet te argumentohen sic i kerkon ligji, ne te kundert kjo perben shkelje te rende bazuar ne nenet 6 e 13 te KEDNJ, nenet 42 e 43 te Kushtetute, neni 63/5 te LPP, neni 100/b i Kodit te Procedurave Administrative.

E drejta per t'u njohur me një vendim te arsyetuar eshte një nga kriteret kryesore te se drejtes per proces te rregullt ligjor dhe detyrimi kryesor ne rastin konkret bie mbi organet e administrates publike qe prodhojne akte/vendime me pasoje per palet pjesemarrese ne proces.

Mungesa e nje vendimi te arsyetuar na cenon te drejten per mbrojtje reale dhe efektive qe ka te beje me te drejten e nje ankimi efektiv, e drejte e mbrojtur gjererisht nga KEDNJ, Kushtetuta dhe legjislacioni i brendshem. Per sa me siper, nga ana jone konstatohet se duke u bazuar ne argumentat e KSHA prane ABP kemi veshtiresi ne paraqitjen e ketij ankimi, pasi nga ana jone vleresohet se nuk ka fatura te dubluara, por edhe sikur te hamendesojme per ndonjeren nga keto fatura, ato nuk jane perfshire ne vleren 40% te fondit limit. Se fundmi, gjithashtu vleresojmese ne nuk kemi paraqitur fatura te realizuara jashte afatit te 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures dhe meqenese nga ana e KSHA nuk eshte evidentuar ndonje fature konkrete, atehere edhe ne lidhje me kete pretendim, argumentimet tona bazohen mbi baza hipotetike dhe hamendesime dhe jo ne prova konkrete, perderia vete autoriteti kontraktor nuk ka evidentuar prova konkrete apo fature konkrete [.....]

II.7. Në datën 18.02.2020, nëpërmjet shkresës me nr.238/1 prot., datë 17.02.2020, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt : “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “ Ali Mihali” Vlorë”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit “Anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “NIKA” shpk nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit teknik pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk plotësohet vlera minimale prej 40 % për furnizimet e ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, “Kriteret e Veccanta të kuaifikimit”, pika 3.3. “Kapaciteti teknik”, pika 1, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

1. *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:*
 - *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes.*
 - *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të furnizuara.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Akt Marrëveshje për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Nika” sh.p.k. dhe shoqërisë “Shabani 2002” sh.p.k., nga ku shoqëria “Nika” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 93.9 % të shërbimeve, ndërsa shoqëria “Shabani 2002” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 6.1 % të shërbimeve. Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Nika” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

“Nika” sh.p.k.

❖ Formulari i kontratës datë 01.08.2016

- Kontratë shërbimi, Nr. 5058/13, datë 01.08.2016, ndërmjet autoritetit kontraktor Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak Nr. 4001 dhe operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k. me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering), Loti IX “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak Nr. 4001 (Vaqarr, Pezë, Rrapi Treshit, Babru), Komanda Mbështetëse Vaqar, Tiranë”, për periudhën 2016-2019, me vlerë 118.789.931 pa tvsh.
- Fatura tatimore shitje për muajt Nëntor 2016 – Dhjetor 2019 (Viti 2016: Nr.75; 85), (Viti 2017: 1; 07; 23; 47; 81; 120; 144; 172; 186; 233; 268; 298). (Viti 2018: Nr. 4; 26; 55; 79; 101; 128;

146; 172; 184; 206; 226; 26; 29), (Viti 2019: Nr.12; 37 55, 77, 94, 124; 145; ;146; 150; 466; 476; 168; 184; 188; 146), në shumën totale 45.843.825,67 lekë pa tvsh, nga të cilat në konsiderim të tre viteve të fundit përlogariten vetëm faturat për periudhën Janar 2017 – Dhjetor 2019 (referuar tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit) vlera totale është 44.086.092,47 lekë pa tvsh.

- ❖ Fatura tatimore shitje Nr.12; 13; 25; 75; 113; 143; 155; 182; 212; 256; 282; 319; 16; 14 ndërnjet blerësit “Shpresa” sh.p.k. dhe shitësit “Nika” sh.p.k., me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi...”, për periudhën Shkurt 2017 – Janar 2018 me vlerë totale 6.133.676
- ❖ Kontratë furnizimi, datë 01.01.2019, ndërmjet porositësit “Junik” sh.p.k. dhe furnizuesit “Nika” sh.p.k. me objekt “Furnizimi me ushqim katering”, me vlerë 12.000.000 pa tvsh.
- Fatura tatimore shitje Nr. 361 datë 18.12.2019 me vlerë 12.000.000 pa tvsh.

“Shabani 2002” sh.p.k.

- ❖ Kontratë furnizimi, datë 10.01.2019, ndërmjet furnizuesit “Shabani 2002” sh.p.k. dhe të furnizuarit “Colombo” sh.p.k. me objekt “Furnizimi me ushqim katering”, me vlerë 3.333.333 pa tvsh.
- Fatura tatimore shitje Nr. 36 datë 23.12.2019 me vlerë 3.333.333 pa tvsh4
- ❖ Fatura tatimore shitje (Nr. 4; 06; 07; 08; 09; 10; 11; 12; 13; 14; 19; 20; 21; 22; 23; 29; 30; 31; 32; 33) për periudhën Janar – Maj 2019, me vlerë totale 2.100.561,17 pa tvsh.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumentave të tenderit ka kërkuar shprehimisht që “operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë: - Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes. - Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të furnizuara”.

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme, pasi operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. në përputhje me pjesën e tij të përqindjes së marrë përsipër nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme në vlerën që i përket sipas kësaj përqindje. Konkretisht, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k., si një nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, për të vërtetuar se ka kryer eksperiencë të mëparshme të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, konstatohet se, ky i fundit ka paraqitur Kontratë shërbimi, Nr. 5058/13, datë 01.08.2016, ndërmjet autoritetit kontraktor Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak Nr. 4001 dhe operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k. me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering), Loti IX “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reparti Ushtarak Nr. 4001 (Vaqarr, Pezë, Rrapi Treshit, Babru), Komanda Mbështetëse Vaqar, Tiranë”, për periudhën 2016-2019, me vlerë 118.789.931 pa tvsh, shoqëruar më Fatura tatimore shitje për muajt Nëntor 2016 – Dhjetor 2019 (Viti 2016: Nr.75; 85), (Viti 2017: 1; 07; 23; 47; 81; 120; 144;

172; 186; 233; 268; 298). (Viti 2018: Nr. 4; 26; 55; 79; 101; 128; 146; 172; 184; 206; 226; 26; 29), (Viti 2019: Nr.12; 37 55, 77, 94, 124; 145; ;146; 150; 466; 476; 168; 184; 188; 146), në shumën totale 45.843.825,67 lekë pa tvsh, nga të cilat në konsiderim të tre viteve të fundit përlllogariten vetëm faturat për periudhën Janar 2017 – Dhjetor 2019 (referuar tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit) vlera totale është 44.086.092,47 lekë pa tvsh. Gjithashtu, operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. ka paraqitur Fatura tatimore shitje Nr.12; 13; 25; 75; 113; 143; 155; 182; 212; 256; 282; 319; 16; 14 ndërnjet blerësit shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. dhe shitësit “Nika” sh.p.k., me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi...”, për periudhën Shkurt 2017 – Janar 2018 me vlerë totale 6.133.676. Për më tepër, operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. ka paraqitur Kontratë furnizimi, datë 01.01.2019, ndërmjet porositesit “Junik” sh.p.k. dhe furnizuesit “Nika” sh.p.k. me objekt “Furnizimi me ushqim catering”, me vlerë 12.000.000 pa tvsh, shoqëruar me Fatura tatimore shitje Nr. 361 datë 18.12.2019 me vlerë 12.000.000 pa tvsh.

Sa më sipur, nisur nga arsyeja e skualifikimit si dhe kërkesa e përcaktuar në kriterin e mësipërm, operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. si një nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. dhe “Shabani 2002” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur si mësipërm nuk arrin të përmbushë kriterin për kontrata të ngjashme, pasi nuk plotëson vlerën që i korrespondon sipas përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Rrjedhimisht, referuar përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë ”Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k., bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pasi nuk plotëson vlerën për kontrata të ngjashme, në përputhje me përqindjen e marrë përsipër. Sa më sipër dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për kontratat e ngjashme nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

III.1.5. Në Kreun VIII, neni 74, *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”*, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të 48 tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit,*

duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.7. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “Nika” sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën për kontratat e ngjashme sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë

para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Shabani 2002” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-45458-12-03-2019, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë*”, me fond limit 166.856.450,4 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 152 Protokolli

Datë 06.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha